

SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar / Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Pedagog për marrëdhëniet ndërkombëtare	Reparti Ushtarak nr.5002, AFA	Tiranë	Pa afat	Po	Po	09.02.2023	23.02.2023
2								
3								

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Pedagog për marrëdhëniet ndërkombëtare, në Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe i Shkencave të Komunikimit, në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë.
2. Kodi i pozicionit: N/A
3. Reparti/Institucioni: Reparti Ushtarak Nr.5002, Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë, në AFA.
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: VKM nr.426, datë 22.06.2022
6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat
7. Data e fillimit të aplikimit: 09.02.2023
8. Data e mbylljes së aplikimit: 23.02.2023
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në: <i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i> <i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i> <i>Tiranë</i>

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës të noterizuar;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike www.mod.gov.al.(linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: Civil/Pedagog
- b. Arsimi : Të ketë përfunduar studimet universitare të nivelit të parë bachelor në degët “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, dhe të ciklit të dytë “Master i Shkencave ose diploma ekuivalente” në fushën e “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, ose fusha të ngjashme brenda ose jashtë vendit.
- c. Kualifikimi: Të ketë kualifikime specifike për didaktikën apo për metodologjinë e kërkimit shkencor.
- d. Trajnimi: Të ketë marrë pjesë në trajnime që lidhen me fushën e studimit.
- e. Eksperienca në Punë: Të ketë eksperiencë pune në mësimdhënie jo më pak se 3 vjet.
- f. Gjuha e huaj: Anglisht

- g. Kërkesa të tjera specifike: Të ketë përvojë pune dhe aftësi të mira në procesin e përgatitjes profesionale dhe mësimdhënëse. Të zotërojë metodologjinë e punës kërkimore e shkencore si dhe aftësi të mira organizuese, drejtuese e didaktike në këtë drejtim Të ketë aftësi të mira organizative, bashkëpunuese e bashkëvepruese.
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: Te plotesoje kriteret per tu pajisur me certifikate te sigurimit te personelit, sipas VKM nr.188/2015. Certifikate Sigurie “Konfidencial”.

Përshkrimi i punës: Përgjigjet për hartimin dhe realizimin e procesit mësimor të Marrëdhënieve Ndërkombëtare në të gjitha programet akademike që zhvillohen në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë në përputhje me synimet dhe udhëzimet për arsimimin në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Detyrat kryesore:

1. Kryen të gjitha detyrat që lidhen me fushën e përgjegjësive në respekt të plotë të ngarkesës mësimore, kërkesave të Statutit të Akademisë, Rregullores së programit të studimit dhe Rregullores së brendshme të institucionit.
2. Zhvillon mësim në lëndën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare sipas programeve të miratuara nga Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe i Shkencave të Komunikimit, dhe Grupi i Shkencave të Marrëdhënieve Ndërkombëtare.
3. Realizon ngarkesën mësimore sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi për arsimin e lartë
4. Merr pjesë në hartimin e programeve mësimorë dhe rishikimin periodik të tyre.
5. Zhvillon aftësitë profesionale nëpërmjet studimit individual dhe pjesëmarrjes aktive në veprimtaritë mësimore dhe shkencore që zhvillohen në Departament, Fakultet dhe në Akademi.
6. Përgjigjet për realizimin e programit mësimor, për lëndët dhe temat e MN, sipas planeve që harton DMNSHK dhe Grupi i Marrëdhënieve Ndërkombëtare.
7. Përgjigjet për përgatitjen e pasurimit e materialeve mësimore (leksione, dispensa dhe tekste), sipas planit të DMNSHK dhe të Grupit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare.
8. Bashkëvepron me pedagogët e grupit për të harmonizuar objektivat, programet dhe planet mësimore.
9. Përgatit tema/teza që do të përpunohen/përgatiten nga studentët gjatë procesit mësimor.
10. Udhëheq studentët për temat individuale.

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i

plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista, zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.